

PROGRAMI PËR NGRITJEN
E KAPACITETEVE
**EFIÇENCA E
ENERGJISE NE
NDERMARRJET
E UK-VE**

Gusht 2015



PROGRAMI PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE – EFIÇENCA E ENERGJISË NË NDËRMARRJET E UK-VE


PËRMBLEDHJE

Programi i Ujit të Danubit mbështet politikën për dialog dhe zhvillimin e kapaciteteve në sektorin e ujësjellës dhe kanalizimeve (UK) në rajonin e Danubit. Programi drejtohet bashkërisht nga Banka Botërore dhe Shoqata Ndërkombëtare e Shoqërive të Ujësjellësve në zonën ujëmbledhëse të lumit Danub (SHNUD), me kapital fillestar të financuar nga Qeveria e Austrisë. Ky program për Efiçencën e Energjisë ka marrë fonde shtesë nga Programi i Asistencës për Menaxhimin e Sektorit të Energjisë (PAMSE). Programi i ujit të Danubit punon me aktorët rajonalë, kombëtarë dhe vendorë (1) për të nxitur dhe informuar politikën e dialogut rreth sfidave kryesore me të cilat përballlet sektori i shërbimeve të ujësjellësit; dhe (2) për të forcuar kapacitetet teknike dhe drejtuese të ndërmarrjeve dhe institucioneve të sektorit, duke përfshirë

përgatitjen dhe mbështetjen e aktiviteteve për përmirësimin e rendimentit të shërbimit.

Programi për Ngritjen e Kapaciteteve- Efiçenca e energjisë në Ndërmarrjet e UK-ve, i zbatuar gjatë periudhës tetor 2013 - gusht 2015, ofroi gjerësisht asistencë teknike dhe ngritje të kapaciteteve në efiçencën e energjisë (EE) për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve në tre shtetet e synuara (Rumani, Serbi dhe Ukrainë). Programi përfshin katër fazat sa më poshtë :

- I. Zhvillimi i një programi për ngritjen e kapaciteteve;
- II. Zbatimi i një programi për ngritjen e kapaciteteve;
- III. Dhënia e mbështetjes për zbatimin e trajnimeve përkatëse; dhe
- IV. Hartimi i dokumentacionit për përjasjen dhe rezultatet.



1 PROCESI I ZBATIMIT TË PROJEKTIT

Projekti përbëhet nga katër faza, zbatimi i të cilave zgjati nga shkurt 2013 në gusht 2015, dhe kishte për objekt final që një numër sa më shumë ndërmarrje të përfundonin raportin e kontrollit të energjisë dhe të identifikonin mekanizmat e përshtatshëm për të financuar masat e identifikuara të EE-së. Çdo seksion, më poshtë, paraqet qëllimet kryesore, punën e kryer për arritjen e objektivave, dhe pengesat e hasura, veçanërisht gjatë kësaj faze, si dhe zgjidhjet e pritshme.

1.1 Faza I: Kërkimi dhe përzgjedhja e vendit

Qëllimi i Fazës I ishte të zhvillohej një dokument bazë për të vlerësuar dhe krahasuar qasjet aktuale në lidhje me EE-në në ndërmarrjet e UK-ve, dhe të rishikoheshin mekanizmat e mundshëm financues në rajon dhe më gjerë. Ky vlerësim i parë do të ndihmonte ekipin e projektit të planifikonte dhe hartonte nga ana konceptuale Programin për Ngritjen e Kapaciteteve për EE-në në ndërmarrjet e UK-ve, mbështetur në praktikatat më të mira ndërkombëtare, qasjet ekzistuese dhe rrethanat lokale.


Ndërmarrjet që aplikuan për thirrje për propozime u vlerësuan mbi bazën e tre kriterëve kryesore: (1) kapaciteti financiar, (2) potenciali teknik, dhe (3) dëshira për të marrë pjesë në këtë nismë. U aplikuan edhe nën-kriteret e mëposhtme:

1.2 Faza II: Zbatimi i një Programi për Ngritjen e Kapaciteteve


Qëllimi i Fazës II ishte të zbatohet Programi për Ngritjen e Kapaciteteve i hartuar në Fazën I për të arritur plane veprimi konkrete, bazuar në rezultatet e kontrollit të energjisë. Ai u zbatua në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet tre konsulentëve kombëtarë dhe shoqatave të ujit. Programi për ngritjen e kapaciteteve u nda në tre sesione trajnimi: (1) një takim pune ndërkombëtar u mbajt si fillim në Sofje, Bullgari, ku u mbledhën të gjithë përfaqësuesit e ndërmarrjeve; (2) takimi kombëtar Nr. 1 u organizuar në secilin nga shtetet pjesëmarrëse, i cili u përqendrua në aspektet teknike; dhe (3) takimi kombëtar Nr. 2 u organizuar në secilin nga shtetet pjesëmarrëse, i cili kombinoi aspektet teknike dhe financiare.

1.2.1 Ndërmarrjet pjesëmarrëse

BB, e mbështetur nga ekipi i Econoler, fillimisht përzgjodhi 36 ndërmarrje nëpërmjet një ftese për palët e interesuara, ftesë kjo e reklamuar në faqen në internet të DËP dhe nëpërmjet shoqatave kombëtare të ujësjellës-kanalizimeve. Ndërmarrjet që morrin pjesë zyrtarisht në projekt analizohen sipas shtetit dhe madhësisë në figurën më poshtë.



NDËRMARRJET PJESËMARRËSE SIPAS SHTETIT DHE MADHËSISË



HARTA E
NDËRMARRJEVE
PJESËMARRËSE


Përveç ndërmarrjeve të llogaritura më sipër, tre ndërmarrje nga shtete të tjera morën pjesë në takimin e parë të punës për interesin e tyre, por nuk morën pjesë në projekt: Prishtina (Kosovë), Prizren (Kosovë), Aquasan mreža (Bosnje dhe Hercegovina).

1.2.2 Seminari i parë

Seminari i parë ishte vendimtar në realizimin me sukses të programit. Ky seminar tre ditor u mbajt nga data 8 prill deri më 10 prill 2014 në Sofje, Bullgari. Ai bëri bashkë gjithsej 39 ndërmarrje, të cilat u këshilluan të dërgonin dy përfaqësues për të marrë pjesë në seminarin e parë: një ekspert teknik dhe një nga stafi drejtues. Qëllimi i seminarit ishte të transmetonte njohuritë bazë mbi kursimin e energjisë në sektorin e ujit, si dhe ngritjen e kapaciteteve të drejtuesve

teknikë për të qenë të aftë të kryejnë kontrollin e energjisë. Bërja bashkë e përfaqësuesve nga të gjitha ndërmarrjet pjesëmarrëse dhe takimi mes kolegëve që hasin të njëjtat sfida të energjisë, krijoi gjithashtu një atmosferë nxitëse dhe motivuese.

Seminare individuale krijuan mundësi: (1) që shoqatat e ujit të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe të paraqesin karakteristikat vendore të EE-së të grupeve të tyre përkatëse; (2) që ndërmarrjet të punojnë si një ekip dhe të realizojnë aktivitetet e ndryshme, të tilla si kryerja e një analize fillestare për EE-në duke përdorur RETScreen® dhe hartimi i një plan veprimi fillestar për EE-në për dobishmërinë e tyre; dhe (3) që ndërmarrjet të marrin udhëzime specifike dhe të përshtatura nga një ekspert teknik ndërkombëtar.



HAPAT PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT TË ENERGJISË

Materiali i Trajnimit për EE-së

Materiali i trajnimit për EE-në u zhvillua mbi bazën e tre mjeteve mësimore: (1) softuerin RETScreen; (2) Manuali për EE-së; dhe (3) formularët për mbledhjen e të dhënave. Ato u ofruan në katër gjuhë: bullgarisht, rumanisht, serbisht dhe rusisht.

Nëpërmjet planeve, u prezantuan të gjitha hapat e nevojshëm për zbatimin e metodologjisë së vlerësimit të energjisë. Në të vërtetë, kryerja e një vlerësimi energjie në një sistem ujësjellësi dhe kanalizime përfshin edhe zhvillimin e seri hapash për të përcaktuar ku dhe sa energji është përdorur në sistem, niveli i rendimentit, masat dhe projektet përkatëse që do të zbatohen për të ulur konsumin dhe koston, përfitimti në kosto ose koston efektive të këtyre veprimeve, një plan zbatimi, dhe metodat për të vlerësuar dhe monitoruar rezultatet e monitoruar.

Vështrim i vlerësimeve dhe rezultateve të seminarit

Sipas pjesëmarrësve dhe folësve, seminari i parë ofroi informacion të vlefshëm, si dhe udhëzime me vlerë për ngritjen e kapaciteteve bazë mbi aspektet teknike financiare dhe drejtuese të zbatimit të projekteve të EE-së në ndërmarrjet e UK-ve.

Programi për ngritjen e kapaciteteve për EE-në në UK synon të trajtojë çështjet dhe sfidat me të cilat përballen ndërmarrjet e ujësjellësit, dhe të propozojë zgjidhje konkrete. Sipas pjesëmarrësve dhe folësve, seminari i parë ofroi informacion të vlefshëm, si dhe udhëzime me vlerë për ngritjen e kapaciteteve bazë mbi aspektet teknike financiare dhe drejtuese të zbatimit të projekteve të EE-së në ndërmarrjet e UK-ve. Kjo tregon qartë se këto platforma për diskutime dhe ndarje njohurish janë shumë të rëndësishme, dhe kanë forcuar motivimin ndërmarrjeve për të zbatuar masat e EE-së. Pjesëmarrësit shpresojnë të ofrohen ende më shumë mundësi të tilla që ata të mund të takohen me kolegët të cilët përballen me probleme dhe realitete të ngjashme, dhe të nxisin kështu nxënien nga kolegët.

1.2.3 Takimi kombëtar nr. 1

Në mes të korrikut 2014, u mbajt takimi kombëtar nr. 1, i cili u organizua në bashkëpunim të ngushtë me shoqatat përkatëse kombëtare të ujit. Të gjitha trajnimet u kryen në gjuhën kombëtare të vendit, dhe pjesëmarrësit paguan për shpenzimet vetjake të udhëtimit (vetëm shërbimi katering dhe vendi i takimit u mbuluan nga SHNUD).

Objektivat

Objektivat kryesorë të takimit kombëtar nr. 1 ishin (1) të paraqiste zhvillimet kryesorë të vendit për EE-në në sektorin e ujit; (2) të mundësonte që ndërmarrjet të

prezantonin zhvillimet e tyre në lidhje me hapat 1 deri në 4 të vlerësimit të energjisë dhe të angazhoheshin në vlerësimin e kolegëve; (3) të zhvillonte mundësinë për masa për EE-në nën drejtimin e konsulentëve kombëtarë; dhe (4) të shqyrtonte mundësitë kryesore për financimin e EE-së.

1.2.4 Takimi kombëtar nr. 2

Takimi kombëtar nr. 2 u mbajt në tetor 2014 (Rumani dhe zyrën rajonale serbe) dhe nëntor 2014 (Ukrainë), dhe u organizua në bashkëpunim të ngushtë me shoqatat përkatëse kombëtare të ujit. Të gjitha trajnimet u kryen në gjuhën kombëtare të vendit, dhe pjesëmarrësit paguan për shpenzimet vetjake të udhëtimit (vetëm shërbimi katering dhe vendi i takimit u mbuluan nga SHNUD).

Objektivat

Objektivat kryesorë të takimit kombëtar nr. 2 ishin (1) të mundësonte ndërmarrjet të prezantonin zhvillimet e tyre në lidhje me hapat 5 dhe 6 të vlerësimit të energjisë dhe të angazhoheshin në rishikimin e kolegëve; (2) të ofronte udhëzime shtesë për zbatimin e kontrolleve të detajuara të energjisë si dhe për hartimin e raporteve të kontrollit; (3) të zhvillonte një sesion trajnimi për masat e financimit në sektorin e UK-ve (nga eksperti financiar i Econoler-it); dhe (4) të zhvillohej një vizitë në një ndërmarrje UK-it dhe njohja me masat EE të zbatuara.

1.3 Faza III: Mbështetje për zbatimin e rezultateve të trajnimit

Objektivi i Fazës III ishte të ofrohej mbështetje e mëtejshme për ndërmarrjet e përzgjedhura në kryerjen e një raporti për kontrollin e energjisë dhe gjetjen e financimit të përshtatshëm për zbatimin e projektit të tyre të EE-së. Gjatë Fazës III, ekipi i projektit i Econoler-it ofroi ndihmë teknike dhe financiare në përshtatje me secilën ndërmarrje pjesëmarrëse. Econoleri dokumentoi aktivitetet mbështetëse dhe zhvillimin e ndërmarrjeve me pesë raporte mujore. Kjo pjesë përfshin edhe një vështrim të përgjithshëm dhe vlerësim të rezultateve të çdo shteti.

1.3.1 Ndërmarrjet pjesëmarrëse

Nga njëra anë, 20 ndërmarrje (rreth 55% e përzgjedhjes fillestare) treguan angazhim të fortë për të dorëzuar një raport kontrolli të energjisë dhe për të identifikuar mekanizma të përshtatshme financimi (lista e plotë paraqitet në Tabelën 5). Nga ana tjetër, 16 ndërmarrje u tërhoqën nga programi gjatë zbatimit të Fazës II, dhe për rrjedhojë nuk arritën në Fazën III. Analiza e mëtejshme e normës së uljes së personelit paraqitet në pjesën 3 për vlerësimin e ndërmarrjeve të programit. Ndër 20 ndërmarrjet më poshtë, 18 mundën të dorëzojnë një

raport kontrolli të energjisë dhe 7 mundën të siguronin financim për projektet e tyre EE-së.

1.3.2 Vlerësim i vendit

Rumania

Qysh kur hyri në Bashkimin Evropian, Rumania ka qenë përherë e më kërkuese për efikasitetin e energjisë, me qëllim përmbushjen e kërkesave për transpozimin e plotë të Direktivës së BE-së për Efikasitetin e Energjisë. Ajo rezultoi në miratimin e Ligjit rumun Nr. 121/2014 për EE-në dhe për krijimin e Drejtorisë për Efikasitetin e Energjisë. Ligji rumun Nr. 121/2014 për EE-në vendos disa detyrime për operatorët ekonomikë që duhet të ndërmarrin një kontroll energjie, të kryer nga profesionistë kompetentë çdo katër vjet, dhe të përgatisin programe për të përmirësuar efikasitetin e energjisë, duke përfshirë masa afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Qeveria planifikon gjithashtu krijimin e një fondi të posaçëm për investime në efikasitetin e energjisë që do të jenë të hapur për një gamë të gjerë furnizuesish të efikasitetit të energjisë, nga shoqëritë e shërbimit të energjisë për konsumatorët finalë. Kuadri ligjor dhe i politikave synon:

- ▶ Të trajnojë kontrollorët e energjisë dhe kryerjen e kontrolleve të pavarura të energjisë;
- ▶ Të krijohen standarde, rregulla dhe rregullore që çojnë në miratimin e teknologjive me rendiment energjetik;
- ▶ Të mbështesë zhvillimin e SHOE-ve (shoqërive për ofrimin e energjisë, të cilat ofrojnë shërbime dhe zbatojnë masa për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në objektet e konsumatorit ndërkohë që konsumatori merr disa rreziqe financiare, pagesa për këto shërbime bazohet në përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe përmbushjen e kriterëve



PAJISJE TIPIKE AKTUALE POMPIMI DHE ELEKTROMAGNETIKE NË RUMANI / FOTO NGA AQUASERV TARGU MURES



VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I REZULTATEVE TË NDËRMARRJEVE RUMUNE

Ndërmarrja	Mundësitë për kursimin e energjisë	Kursim i energjisë (%)	Investimi Total (EUR)	Financim i konfirmuar
Aguaserv Targu Mures	Zëvendësim i pompave nr. 1 dhe 2	34.65	30,994	X
	Instalim i inverterit për rregullimin e shpejtësisë (VSD)			
Apaserv Satu Mare	Zëvendësim i pompave të ujit në Carei	21.81	30,634	X
	Zëvendësim i pompave të ujit në Sanatatii	40.23	7,474	
	Zëvendësim i pompave të ujit në rrugën Independentei	23.84	5,068	
	Zëvendësim i pompave të ujit në rrugën Closca	31.07	1,921	
Focsani	Zëvendësim i pesë kompresor të tipit GM50L	20.10	126,483	X
Raja Constanta	Ndërtimi i dy nënstacioneve tërësisht të pajisur për transformimin e energjisë në vend, në godinat ekzistuese	-	1,198,745	X
Buzau	Zëvendësim i motorëve dhe pompave	40.56	62,504	X
Brasov	Zëvendësim i pompave të ujit dhe motorëve elektrik	18.00	25,400	X
TOTAL			1,489,223	

të tjera të performancës, të rëna dakord nga palët).

- Krijimin e një fondi investimi të posaçëm për efikasitetin e energjisë dhe financimin e instrumenteve apo stimuljeve tatimorë për zbatimin e teknikave me rendiment energjetik.


Kjo mund të nxisë ndërmarrjen e iniciativave për EE-në dhe mund të japë si rezultat shfaqjen e furnizuesve të rinj, të specializuar të shërbimeve në energji. Gjithashtu, do të mund të ngjallë rritjen e interesit tek bankat për të ofruar stimuj financiar për aktorët në këtë fushë.

Në ndërmarrjet e sektorit rumun të UK-ve, janë financuar tashmë projekte të mëdha në infrastrukturorë nga grante evropiane, të cilat ndihmuan gjerësisht arritjen e standardeve në pajtim me standardet evropiane të mjedisit dhe patën një ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e komuniteteve. Kjo qasje kishte për qilim të rriste si kostot e investimit në efikasitet ashtu edhe kostot operative të objektivave të rinj të investimeve.

Përafërsisht 7 miliardë Euro u investuan në sektorin rumun të ujit. U përditësuan teknologjitë e qarkullimit të ujërave të zeza dhe në impiantet e trajtimit, dhe kostoja e energjisë elektrike ra nga 20% në 10% në sajë të kostove operative më të ulëta. Megjithatë, ndërmarrjen e ujësjellësit dhe kanalizimeve kanë ende potencial të madh për kursimin e energjisë. Ndërmarrjet e UK-ve në Rumani kanë përvojë të mjaftueshme në menaxhimin e projekteve të EE-së, por Programi i Ujit të Danubit u ofroi mundësinë të analizonin zgjidhje të ndryshme të EE-së pa qenë nevoja të shpenzonin për shoqëri të specializuara.

Nga 9 ndërmarrjet rumune pjesëmarrëse në fillim, vetëm 6 paraqitën një kontroll të energjisë dhe 5 siguruar financim.


Tabela tregon rezultatet sipas raportit të kontrollit të energjisë. Megjithatë, gjatë zbatimit të Fazës III, "Aguaserv Targu Mures" dhe "Apaserv Statu Mare" ndryshuan planet e tyre të projektit dhe investimit në EE.



PAJISJE TIPIKE AKTUALE POMPIMI DHE ELEKTROMAGNETIKE NË RUMANI / FOTO NGA AQUASERV TARGU MURES

Zyra rajonale serbe

Ndërmarrjet serbe kishin kryesisht personel të mirë-trajnuar i cili realizoi me sukses të gjitha analizat. Duke qenë se sistemet në ndërmarrje janë jo të efektshme dhe shumica të vjetruara, përfaqësuesit e tyre pranuan nevojën për të përmirësuar EE-në në gjenerim dhe përpunim të ujit. Gjithashtu, ndërmarrjet u përballën me një sërë sfidash gjatë zbatimit të Fazës III. Serbia ka një borxh prej 70% të PBB-së së saj dhe asnjë qeveri, vendore apo qendrore, nuk do të linja kredie shtesë. Ndërmarrjet drejtohen nga organet e qeverisjes vendore, të cilat shpesh kanë axhenda politike, dhe vendimet që ato marrin, shpesh janë të lidhura me strategjitë politike. Shpesh ka mospërputhje ndërmjet drejtuesve të lartë dhe ekspertëve teknikë në lidhje me rëndësinë



NDËRMARRJA KOMUNALE BEOGRAD, IMPIANTI I UJIT TË PIJSHËM

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I REZULTATEVE TË NDËRMARRJEVE SERBE

Ndërmarrja	Mundësitë për kursimin e energjisë	Kursim i energjisë (%)	Investimi Total (EUR)	Financim i konfirmuar
Zvezdara (Beograd)	Ndryshim i pompës nr. 1 në nënstacionin e pompimit CS17a	60.1	437,724	
	Ndryshim i pompës nr. 2 në nënstacionin e pompimit CS17a	56.5		
	Ndryshim i pompës nr. 3 në nënstacionin e pompimit CS17a	56.1		
Vracar (Beograd)	Ndryshim i pompës nr. 1 në nënstacionin e pompimit CS16	53.3	325,071	
	Ndryshim i pompës nr. 2 në nënstacionin e pompimit CS16	51.5		
	Ndryshim i pompës nr. 3 në nënstacionin e pompimit CS16	54.8		
Subotica	Rritja e prodhimit t bogazit me 10%-15%	-	540,000	
Izvoriste (Leskovac)	Kursim i energjisë në mirëmbajtje dhe operim	39.3	14,238	
Gorina (Leskovac)	Ndërtimi i një hidrocentrali të vogël	-	379,080	
Biljeljina (BiH)	Zëvendësim i pompës ekzistuese 64 kW me pompë 45kW në stacionin e pompimit B2	-	32,562	
	Zëvendësim i pompës ekzistuese 75kW me një pompë 45kW në pusin B11	-		
	Zëvendësim i pompës ekzistuese 75kW me pompë 45kW në pusin B12l	-		
Niksic (Mali i Zi)	Zëvendësim pompe në Vitalac	39.7	69,000	
	Zëvendësim pompe në rrugën Široka	43.1		
	Zëvendësim pompe në Donja Luka škola	40.1		
	Zëvendësim pompe në G. Rubeža	46.2		
	Zëvendësim pompe në Donja Luka Relejska	42.9		
	Zëvendësim pompe në Donja Rubeža	19.1		
Naissus (Nis)	Ndryshim i pompave nr. 1-2 në Mediana 2	51.2	82,054	
	Ndryshim i pompave nr. 3-4 në Mediana 2	64.2		
TOTAL			1,797,675	

e një strategjie të ardhshme zhvillimi për ndërmarrjet, mungesa e të cilës pengon zbatimin e projekteve të EE-së të identifikuar. Çdo vendim financiar kërkon pëlqimin e drejtuesve, shpesh të emëruar politikisht dhe që nuk e kanë idenë e nevojave reale dhe afatgjata. Për më tepër drejtuesit e ndërmarrjeve shmangin angazhime financiare afatgjata, të tilla si marrja e huave nga bankat.

Pa dyshim që sektori i ujit në Serbi ka nevojë për ndihmë financiare për të rritur EE-në në impiantet e gjenerimit dhe përpunimit të ujit. Ajo çfarë do të nevojitej janë huatë e pakthyeshme dhe me interes të ulët. Është e rëndësishme që të kapërcehen problemet që lindin nga kreditë e pamundura për tu shlyer në kohë. Sektori i ujit në Serbi duhet t'i drejtohet fondeve që ofrojnë vendet e zhvilluara dhe BE-ja që janë të destinuar për këtë qëllim. Kreditë tregtare që ofrohen nga bankat nuk janë mjaftueshëm të favorshme, prandaj ndërmarrjet duhet t'i shmangin ato.

Nga 14 ndërmarrjet pjesëmarrëse në fillim nga zyra rajonale serbe, vetëm 8 paraqitën kontroll të energjisë dhe asnjë nuk siguroi financim.

Ukraina

Për zbatim e Fazës III në Ukrainë u desh shumë punë për shkak të një sërë faktorësh:

- Shumica e pjesëmarrësve nga Ukraina ishin pjesëmarrës në Projektin e Infrastrukturës Urbane të Bankës Botërore (BB-PIU). Ky projekt ka ofruar hua afatgjata me normat më të ulëta të mundshme të interesit në Ukrainë. Vlera e shumave të huave ndryshon nga 10-50 milion dollarë amerikanë, në varësi të ndërmarrjes, të cilat mbulonin tërësisht

- zbatimin e masave kryesore të efijencës së energjisë në ndërmarrje. Disa ndërmarrje ngritën pretendime se personeli i tyre teknik do të ishte i zënë me ngarkesën e punës në PIU2, gjë që i detyroi ato të ndalonin bashkëpunimin me Programin e Efijencës së Energjisë në UK-të.
 - Ekonomia e Ukrainës është në recesion qysh prej fillimit të vitit 2014, dhe norma e inflacionit ka arritur majat qysh me nisjen e projektit (25% në janar 2015 krahasuar me 6.9% në prill 2014). Këto kushte të tmerrshme ekonomike dhe financiare më së shumti penguan investimet në EE. Këto kushte të rënda ekonomike dhe financiare ka penguar në masë të madhe investimet e EE. Buxhetet e ndërmarrjeve të ujit janë tkurrur për shkak të deficitit publik, dhe administrata e lartë heziton të marrë hua për shkak të normave të larta të interesit (të cilat mund të arrijnë deri në 30% në bankat tregtare, sipas këshilltarit tonë kombëtar). Gjithashtu, zhvlerësimi i monedhës kombëtare pengon që ndërmarrjet të importojnë materiale të reja (si pompat).
 - Kur morën pjesë në Seminari e parë, në fakt të gjitha ndërmarrjet nga Ukraina prisnin të merrnin financime shtesë me grante. Prandaj disa nga ndërmarrjet nuk kishte dërguar asnjë specialist teknik (inxhinier elektrik) në takim e nisjes i cili të mund të siguronte një kontroll të energjisë. Gjithashtu, përfaqësuesit e ndërmarrjeve nuk e kuptonin pse duhej të hartonin një raport kontrolli të energjisë. Ata prisnin që Banka Botërore tu siguronte një këshilltar ose tu jepte financim për të punësuar një këshilltar (siç ishte në kuadër të PIU-së).
- Nga 13 ndërmarrjet pjesëmarrëse fillimisht nga Ukraina, vetëm 4 mundën të paraqesin kontroll të energjisë dhe 2 siguruan financim.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I REZULTATEVE TË NDËRMARRJEVE UKRAINASE

Ndërmarrja	Mundësitë për kursimin e energjisë	Kursim i energjisë (%)	Investimi Total (EUR)	Financim i konfirmuar
Chernihiv	Zëvendësim i stacionit të pompimit të ujërave të zeza	32.0	344,250	
	Zëvendësim i kompresorëve të impiantit e trajtimit të ujërave të zeza			
Kremenchuk	Instalim i në gjeneratori të kombinuar me nxehtësi dhe energjie elektrike	-	2,187,000	
Kharkiv no 26	Zëvendësim i pompave	75.0	174,590	X
	Instalim i inverterit për rregullimin e frekuencës (VFD)			
Pyatihatki (Kharkiv)	Zëvendësim i pompave	47.4	510,228	X
	Instalim i inverterit për rregullimin e frekuencës (VFD)			
TOTAL			3,216,068	

1.4 Faza IV: Dokumentimi i rezultateve dhe qasjes

Përveç dorëzimit të një raporti final për të dokumentuar rezultatet e projektit, objektivi i fazës së katërt ishte të përgatitej një variant final i riparo i të gjitha materialeve dhe mjeteve të trajnimit të disponueshme për tu përdorur në aktivitete të ardhshme. Për të lehtësuar zbatimin dhe përshkallëzimin e nismës nga shoqatat kombëtare të ndërmarrjeve të ujit, u nxorën mësimet e marra në mënyrë të hollësishme për secilën nga fazat.

Dokumenti dhe mjetet fillestare të trajnimit u njehsuan nga ekspertët tanë ndërkombëtarë

dhe vendorë për të ndrequr ose qartësuar disa informacione, mbi bazën e komenteve të pjesëmarrësve gjatë seminarit të parë. Të tre këshilltarët kombëtarë gjithashtu ri-shqyrtuan në tërësi përkthimet e dokumenteve të shkruara për të identifikuar dhe korrigjuar gabimet dhe dobësitë në aspektin teknik.


Econoler zhvilloi dy runde vlerësimi të programit të trajnimit: (1) pas seminarit të parë, dhe (2) në fund të programit. U morën komentet kryesore nga ndërmarrjet dhe këshilltarët kombëtarë dhe u trajtuan në variantin përfundimtar të materialit të trajnimit.

2 REZULTATET E PROJEKTIT

Në përgjithësi, rezultatet e projektit ishin pozitive dhe ndërmarrjet treguan interes të madh dhe përkushtim ndaj programit. Kjo pjesë do të paraqesë dhe shqyrtojë rezultatet kryesore të projektit, përfshirë numrin e ndërmarrjeve që dorëzuan me sukses një raport kontrolli të energjisë, identifikuan burime financimi, dhe ofruara detaje për investimet e konfirmuara.

2.1 Vështrim i përgjithshëm i rezultateve të ndërmarrjeve

Nga 36 ndërmarrje të përzgjedhura, 20 arritën në Fazën III dhe kërkuan mbështetje për të përfunduar kontrollet përkatëse të energjisë apo për të identifikuar mekanizmat e përshtatshëm financiarë. Prej këtyre 20 ndërmarrjeve, 18 mundën të dorëzonin një raport kontrolli të energjisë, ndërsa vetëm 7 konfirmuan financimin.



PJESËMARRJA E NDËRMARRJEVE E ANALIZUAR SIPAS REZULTATIT DHE SHTETIT

2.2 Investimet e identifikuara dhe të marra përsipër

Tabela më poshtë paraqet rezultatet e agreguara të projektit.

REZULTATET E AGREGUARA TË PROJEKTIT

Rezultatet e projektit		
Investimet e identifikuara	Investimet e marra përsipër	
1,489,223	1,678,102	Rumani
1,797,675	0	Serbi
3,216,068	684,818	Ukrainë
6,502,966	2 362 920	TOTAL

Tabela e dytë tregon shtatë investimet që u konfirmuan nga ndërmarrjet, të cilat përfaqësojnë në total 2,362,920 EUR.

TOTALI I INVESTIMIT PËRFUNDIMTAR DHE BURIMET E FINANCIMIT PËR PROJEKTET E EE-SË TË MARRA PËRSIPËR

Ndërmarrja	Shteti	Burimi i financimit	Investimi Total (EUR)
Aquaserv (Targu Mures)	Rumani	SHOE	320,000
Focsani	Rumani	Vetë financim	126,483
Apaserv (Statu Mare)	Rumani	Vetë financim	7,474
Raja (Constanta)	Rumani	Investitor privat	1,198,745
Brasov	Rumani	Vetë financim	25,400
Kharkiv nr 26	Ukrainë	Fonde të bashkisë	174,590
Pyatihaki (Kharkiv)	Ukrainë	Fonde të bashkisë	510,228
TOTAL			2 362 920

2.3 Vlerësim i rezultateve të projektit

2.3.1 Lidhje e fortë ndërmjet pjesëmarrjes në programin për ngritjen e kapaciteteve dhe dorëzimit të raport kontrollit të energjisë

Kur u analizua pjesëmarrja e ndërmarrjeve në trajnim, u gjet që ka një lidhje të fortë ndërmjet pjesëmarrjes në tërë programin e trajnimit dhe dorëzimit të raport kontrollit të energjisë.

2.3.2 Mospërputhje të mëdha ndërmjet rezultateve të vendeve

Gjithashtu, rezultatet tregojnë mospërputhje të mëdha ndërmjet arritjeve të vendeve, të cilat mund të shpjegohen nga faktorë të shumtë:

- ▶ Përmasa e ndërmarrjeve pjesëmarrëse
- ▶ Borxhi publik dhe gjendja ekonomike
- ▶ Kuadri ligjor dhe politika
- ▶ Stabiliteti politik
- ▶ Qëndrueshmërinë e tregut të SHOE-ve

2.3.3 Shumë projekte çuan në investime modeste, shumica vetë financime të ndërmarrjes, për shkak të mungesës së një strategjie të planifikuar për financimin e EE-së

Qysh nga seminari i parë, ndërmarrjet u informuan se programi nuk përfshin asnjë mekanizëm financiar, dhe se një nga objektivat për ta ishte të identifikonin vetë burime financiare. Kjo gjë ndikoi në pasjen e më shumë projekteve me vetë financim ose projekte të financuara nëpërmjet fondeve të bashkisë. Asnjë kredi nuk u mor nga institucione financiare.

3 VLERËSIM I PROGRAMIT PËR NDËRMARRJE

Ndërmarrjet përgjithësisht ishin shumë të kënaqura me sesionet trajnuese dhe materialet e trajnimit që u ofruan. Është për tu theksuar se materiali ishte gjithëpërfshirës dhe i lehtë në përdorim dhe përfshin një qasje të strukturuar të kontrollit të energjisë dhe metodologji vlerësimi. Ato aspekte e bëjnë materialin shumë të përshtatshëm që ndërmarrjet ta përdornin në mënyrë të pavarur ndërmjet çdo trajnimi. Në fakt, gjatë analizës së pjesëmarrjes së ndërmarrjeve në sesionet trajnuese, u konstatua një e lidhjes e fortë ndërmjet ndjekjes së programit të trajnimit në tërësi dhe dorëzimit të raportit të kontrollit të energjisë. Në të vërtetë, nga 18 ndërmarrjet që dorëzuan kontrollin të energjisë, 15 morën pjesë në të tre sesionet trajnuese.

“Ofrimi i një qasje të strukturuar të kontrollit të energjisë dhe metodologji vlerësimi për sistemet e ujësjellësit, i ndihmoi realisht ndërmarrjet”.

– **Dragoslav Šumarac**, Këshilltar kombëtar i EE për Zyrën rajonale serbe

Shumica e ndërmarrjeve ishin të mendimit se prezantimi me softuerin “RETScreen” ishte një vlerë e shtuar e programit të trajnimit. Ky program i bazuar në Eksel për analizimin e projekteve të energjisë së pastër iu erdhi në ndihmë ekspertëve teknikë dhe personelit drejtues për të përcaktuar me shpejtësi dhe pa shpenzuar nëse projektet e mundshme të EE-së ishin të realizueshëm nga ana teknike dhe financiare. Ky mjet provoi se është shumë i lehtë në përdorim dhe mbështet punën e ekspertëve vendorë në çdo vend pa qenë nevoja për të bërë rregullime. Pjesëmarrësit vlerësuan mundësinë që iu dha për të praktikuar gjatë sesioneve të takimeve individuale dhe takimeve kombëtare.

“Programi për ngritjen e kapaciteteve u ofroi ekspertëve teknikë aftësi për të kryer kontrollin e energjisë dhe për të informuar drejtuesit mbi masatë më të mira për kursimin e energjisë.”

– **Yuri Yarochenko Vadimovitch**, Shef i Departamentit të Energjisë, Kharkiv Nr. 26 (Ukrainë)

Mbi të gjitha, ndërveprimi ndërmjet pjesëmarrësve, të cilët, të gjithë përballen me të njëjtat sfida të energjisë në ndërmarrjet përkatëse të UK-ve, ishte pjesa më përfituese e projektit. Në takimet kombëtare, ndërmarrjeve iu ofrua mundësia të paraqesin zhvillimin e tyre dhe pengesat që kishin hasur. Më pas, të gjithë mundën të merrnin pjesë dhe të përftonin nga procesi i shqyrtimit të kolegut, i mbikëqyruar nga Këshilltari Kombëtar i cili mund të ndërhynte nëse ishte e nevojshme.

“Ndërveprimi ndërmjet pjesëmarrësve, mundësia për të ndarë njohuritë dhe eksperiencat ndërmjet kolegëve përgjegjës për EE-në në sektorin e ujit, ishte përfundimi më i madh i projektit.”

– **Darius Bör**, Ekspert Financiar i Satu Mare (Rumani)

4 MËSIMET E NXJERRA

Rritja e numrit të sesioneve trajnuese dhe mundësive për aplikime praktike

Dy takimet kombëtare u konsideruan si platforma më e mirë ku përfaqësuesit e ndërmarrjeve mund të ndanin eksperiencat e tyre, të shkëmbejnë njohuri dhe të shqyrtonin punën e njëri-tjetrit me anë të vlerësimit të kolegëve. Siç theksoi këshilltari serb, “Është absolutisht e nevojshme që përfaqësuesit e ndërmarrjeve të përfshihen në mënyrë aktive dhe vazhdimisht përgjatë zhvillimit të programit, për të pasur reagime sa më të shpeshta dhe të përgjithshme nga ana e tyre.”

Ofrimi i sa më shumë trajnimeve gjithëpërfshirëse për RETScreen

Gjatë vlerësimit të seminarit të parë, ndërmarrjet shfaqën bindjen se “RETScreen” ishte një vlerë e shtuar për nxitjen e masave të kursimit të energjisë dhe për identifikimin e investimeve të nevojshme.

Përfshirja e BRE-ve në kurrikulën e trajnimit

Disa ndërmarrje shfaqën interes të madh në uljen e konsumit të energjisë duke zbatuar nismat e burimeve të rinovueshme të energjisë.

Ndryshimi i strukturës së seminarit të parë

Për shkak të mbulimit të plotë të aspekteve teknike dhe financiare të EE-së, shumë e vlerësuan seminarin e parë tre-ditor të një rëndësie të madhe. Në fakt rezultoi se, mbajta e një seminari të parë ndërkombëtar, përveç mbledhjes së të gjithë pjesëmarrësve në një vend dhe krijimi i një atmosfere motivuese, ka përparësi të kufizuara. Organizimi i tre seminareve kombëtare duket si një zgjidhje më e përshtatshme.

Përfshirja e më shumë aktorëve në sesionet trajnuese

Siç ishte planifikuar fillimisht në program, shoqatat të ndërmarrjeve të ujit u përfshinë gjatë gjithë programit për ngritjen e kapaciteteve, dhe përfshirja e tyre dëshmoi se ishte shumë e dobishme në organizimin dhe lehtësimin e takimeve kombëtare.

Përveç kësaj përfshirjeje të çmuar, rekomandohet që të përfshihen edhe drejtuesit e lartë të ndërmarrjeve, përfaqësues të bashkisë dhe institucioneve financiare që të marrin pjesë në zbatime të ardhshme të projektit.

Ofrimi i burimeve shtesë për pajisje matëse

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme zakonisht kanë më pak ekspertizë të brendshme teknike dhe kanë mangësi në pajisje për të kryer vetë kontrole të energjisë. Duhet të mobilizohen burimet shtesë për të mbështetur këto ndërmarrje, të tilla si një buxhet i veçantë për pajisje matëse (të marra me qira ose të blera).

Të sigurohet që programi të trajtojë sfidat e financimit

Shpesh herë, ndërmarrjet shfaqën nevojën për projekte që të përfshijnë mekanizma financimi të përshtatura. Gjetja e financimit në tregun e kredive të vendeve përkatëse, në shumicën e rasteve, ishte ose shumë e shtrenjtë (Ukrainë, Zyrën rajonale serbe) ose shumë e vështirë për tu trajtuar nga brenda dhe për të marrë miratimin nga bashkia kryesore.

Rritja e komunikimit ndërmjet ndërmarrjeve pjesëmarrëse

Ndërmarrjet treguan se, ato kishin pak mundësi (përveç dy takimeve kombëtare) për të shkëmbyer mendime me kolegët e tyre në lidhje me pengesat e hasura, çështje teknike, skemat e mundshme të financimit, etj. Me siguri, tashmë ato do të përfitojnë nga kanalet e zgjeruara të komunikimit.



EFIÇENCA E ENERGJISË NË NDERMARRJET E UK-VE

PROGRAMI PËR NGRITJEN
E KAPACITETEVE



Pika e Kontaktit për Projektin

office@danube-water-program.org
www.danube-water-program.org



Smart policies, strong utilities, sustainable services

www.danube-water-program.org